

**TERMAT DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR PROKURIMIN E MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE NË  
BANKËN RAIFFEISEN KOSOVO J.S.C.  
(në vazhdim si TKP)**

## 1. PËRKUFIZIME

**Kontrata** nënkupton marrëveshjen përkatëse me shkrim për shitjen e mallrave dhe/ose kryerjen e shërbimeve, si dhe çdo urdhër blerje, marrëveshje blerjeje, fushëveprim i punës, deklaratë e punës, etj., në lidhje me kontratën e lidhur ndërmjet klientit dhe furnitorit dhe e cila përmban përshkrimin e mallrave dhe/ose shërbimeve dhe provizionet e tjera përkatëse.

**Klienti** nënkupton bankën Raiffeisen J.S.C në Kosovë, e cila blen mallra dhe/ose shërbime nga furnitori.

**Mallra** nënkupton produktet që do të blihen nga klienti prej furnitorit si dhe rezultatin / produktin / efektin e shërbimeve të kryera.

**TKP** nënkupton termet dhe kushtet e përgjithshme për prokurimin e mallrave dhe/ose shërbimeve.

**Me shkrim** nënkupton të jetë në formë të shkruar përmes anekseve, amendamenteve, letrave dhe të nënshkruara nga furnitori dhe/ose përfaqësuesit e autorizuar përkatës të klientit (siç zbatohet).

**Palët** nënkupton bashkërisht furnitorin dhe klientin dhe "Pala" nënkupton cilindo prej tyre.

**RBKO** nënkupton bankën Raiffeisen J.S.C në Kosovë me adresën e saj në rr. Robert Doll nr.99, Prishtinë.

**Shërbimet** nënkuptojnë shërbimet e ofruara nga furnitori për klientin, por duke përjashtuar licencat dhe shërbimet e integritetit të sistemit në fushën e TI-së.

**Furnitori** nënkupton entitetin që shet mallrat dhe /ose ofron shërbimet për klientin.

## 2. OFERTA dhe FUSHËVEPRIMI

**2.1** Këto TKP do të zbatohen për të gjitha blerjet e mallrave dhe shërbimeve nga klienti prej furnitorëve. Në rast se shërbimet konsiderohen si shërbime të jashtë-kontraktuara apo "outsourcing", do të zbatohen edhe kushte që dalin nga Udhëzuesi i Autoritet Bankar European për shërbimet e jashtëkontraktuara dhe Rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës.

**2.2** Kontrata do të përmbajë dispozita të tjera në lidhje me përshkrimin dhe përmbajtjen e mallrave dhe shërbimeve, siç janë, periudhat kohore dhe afatet, çmimi blerës për mallrat dhe shërbimet, detyrimet e veçanta të palëve dhe çdo dispozitë tjetër e nevojshme

**2.3** Këto TKP do të jenë pjesë e pandashme e kontratës. Në rast të mospërputhjeve ndërmjet këtyre TKP-ve dhe kontratës, dispozitat përkatëse të kontratës do të mbizotërojnë.

**2.4** Çdo ndryshim i synuar i kontratës (gjithashtu edhe nëse bëhet përmes telefonit ose me gojë) do të bëhet detyrues për palët vetëm pasi të jetë rënë dakord me shkrim nga palët. Megjithatë, çdo porosi individuale në lidhje me kontratën mund të bëhet nga klienti po ashtu edhe në formë elektronike.

Furnitori është i obliguar ta kontrollojë llogarinë e tij përkatëse të postës elektronike çdo ditë dhe të konfirmojë porosinë e tillë të klientit sa më shpejt që të jetë e mundur. Në cilindo rast, porosia elektronike nga klienti do të konsiderohet si e pranuar nga furnitori, përveç nëse furnitori e kundërshton një porosi të tillë elektronike të klientit brenda 2 ditëve nga dërgimi i një porosie të tillë nga klienti.

**2.5** Furnitori nuk ka të drejtë të punësojë palë të treta për kryerjen e kontratës, përveç nëse është miratuar me shkrim paraprakisht nga klienti (një miratim i tillë mos të refuzohet pa arsye). Furnitori do të marrë përsipër përgjegjësinë e plotë për palët e treta dhe punësimi i këtyre palëve të treta nuk do ta lirojë furnitorin nga detyrimet e tij në lidhje me kontratën.

**2.6** Shërbimet do të ofrohen dhe do të kryhen me çmimin fikse. Në rast se palët kanë rënë dakord që shërbimet të ngarkohen në bazë të orëve të punuara dhe shpenzimeve të shkaktuara (marrëveshja e bazuar në kohë dhe materiale), furnitori duhet të ofrojë një vlerë të përafërt të tarifave për shërbimet dhe një shumë maksimale për shërbimet e tilla. Shuma e tillë maksimale nuk duhet të tejkalohet nga furnitori.

### **3. LIFERIMI**

**3.1** Mallrat do të liferohen dhe shërbimet do të kryhen në vendin, në datën dhe në kohën e rënë dakord nga palët në kontratë. Në rast se nuk është caktuar koha e liferimit, mallrat do të liferohen vetëm në ditë pune gjatë orëve të punës (9:00-16:00).

**3.2** Vendi i kryerjes do të jetë vendi ku mallrat duhet të liferohen ose shërbimet të kryhen në pajtim me kontratën.

**3.3** Në rast se furnitori nuk është në gjendje të liferojë mallrat ose të kryejë shërbimet në vendin ose në datën dhe kohën e rënë dakord nga palët në kontratë për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të furnitorit (p.sh., fuqia madhore, greva, katastrofat natyrore, veprimet e luftës), klienti mundet - në diskrecionin e tij të vetëm - të pajtohet për shtyrjen e afatit të liferimit/realizimit. Në rast se furnitori nuk pajtohet për një shtyrje të tillë, klienti ka të drejtë të shkëpusë kontratën pa u ballafaquar me ndonjë pretendim nga furnitori.

**3.4** Pas liferimit të mallrave ose kryerjes së shërbimeve, furnitori do t'i dorëzojë klientit fletë dërgesën, e cila përmban datën dhe numrin e kontratës, numrin dhe datën e lëshimit të fletë dërgesës dhe të gjitha informacionet e nevojshme për llojin, madhësinë dhe çmimin e dërgesës si dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme. Deri në nivelin arsyeshëm të realizueshëm, të gjitha dokumentet e tilla do të ofrohen në gjuhën vendore të klientit dhe në gjuhën angleze.

**3.5** E drejta dhe pronësia e mallrave do t'i kalojë klientit pas pranimit nga klienti.

**3.6** Furnitori mund të shmanget nga termat dhe kushtet e rëna dakord për liferimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve vetëm me kusht që ka njoftuar klientin paraprakisht në përputhje me rrethanat për një shmangie të tillë të synuar dhe klienti e ka dhënë pëlqimin e tij me shkrim për këtë qëllim.

**3.7** Furnitori do t'i ofrojë klientit fletët e hollësishme të punës për shërbimet e kryera, duke përfshirë informacione të hollësishme mbi shërbimet e kryera, kohën e punës të personave të cilët i kryejnë shërbimet e tilla dhe të kostove dhe shpenzimeve të lidhura me to. Fletët e tilla të punës do t'i ofrohen klientit së bashku me faturën ose në baza mujore (cilado që ndodhë më herët).

**3.8** Furnitori do të sigurojë licencat, lejet, miratimet ose pëlqimet e kërkuara për liferimin dhe operimin e mallrave.

#### **4. PAGESA**

**4.1** Pasi të jenë liferuar mallrat ose të jenë kryer shërbimet në përputhje me kontratën, furnitori do të lëshojë faturën e tij.

**4.2** Fatura do të përmbajë së paku informacionet vijuese:

- Emri dhe adresa e furnitori dhe klientit
- Numri unik i faturës
- Shuma dhe përshkrimi i mallrave dhe /ose shërbimeve
- Çmimi i blerjes - Numri i urdhër blerjes
- Kushtet dhe data e pagesës
- Numri i regjistrimit dhe tatimor i furnitorit dhe klientit - TVSH (nëse ka)
- Data dhe nënshkrimi i furnitorit

**4.3.** Në rast se fatura nuk përmban të gjitha këto informacione, klienti nuk është i detyruar të pranojë faturën dhe koha e pagesës nuk fillon para se klienti të pajiset me një faturë e cila përmban të gjitha këto informacione.

**4.4.** Nëse nuk është rënë dakord ndryshe, çmimi i blerjes i rënë dakord për mallrat dhe/ose shërbimet tashmë do të përfshijë TVSH-në ose tatimet e tjera të cilave furnitori i nënshtrohet (ngarkesave, taksave, taksave doganore ose tagrave të tjera), si dhe çdo kosto tjetër që kërkohet në lidhje me mallrat ose shërbimet (p.sh. liferimi, paketimi, trajtimi, sigurimi, shpenzimet e udhëtimit, koha e udhëtimit, shpenzime "xhepi", akomodimi, etj.).

**4.5.** Furnitori do t'i jap klientit të gjitha informatat e nevojshëm për të shmangur ndonjë tatim të dyfishtë. Në rast se furnitori dështon ta bëjë një gjë të tillë, të gjitha shpenzimet e tilla do të barten nga furnitori.

**4.6.** Klienti do ta shlyejë faturën e pranuar në afat prej 28 ditësh pas pranimit të saj.

**4.7.** Të gjitha pagesat do të bëhen vetëm përmes transferit bankar në llogarinë e furnitorit të mbajtur në një bankë në vendin e furnitorit. Secila palë do të bartë shpenzimet e veta në lidhje me transferin e tillë.

**4.8.** Çmimi blerës do të jetë i denominuar në euro. Në raste të jashtëzakonshme, klienti dhe furnitori mund të bien dakord me shkrim që çmimi blerës të jetë i denominuar në ndonjë valutë tjetër ose që çmimi blerës i cili është i denominuar në euro të paguhet në valutë tjetër. Për këtë të fundit, palët do të bien dakord për kursin e këmbimit ndërmjet euros dhe valutës përkatëse përpara nënshkrimit të kontratës.

#### **5. GARANIONI**

Mosliferimi/Moskryerja

**5.1** Në rast se mallrat nuk janë liferuar ose shërbimet nuk janë kryer nga furnitori në datën, vendin dhe kohën e rënë dakord, klienti do t'i japë furnitorit një periudhë të arsyeshme shtesë "grace" për liferimin e mallrave ose kryerjen e shërbimeve. Pavarësisht nga ndonjë gabim në anën e furnitorit, klienti do të ketë të drejtën e një ndëshkimi kontraktual në shumën prej 3% të vlerës së kontratës për çdo ditë deri në datën kur mallrat janë liferuar në të vërtetë ose shërbimet janë kryer.

**5.2** Klienti do të ketë të drejtë të shkëpusë kontratën në rast se furnitori nuk i liferon mallrat ose nuk i kryen shërbimet brenda periudhës së dhënë shtesë "grace". E drejta e klientit për të pretenduar zhdëmtim shtesë nuk do të preket nga ndëshkimi kontraktual sipas klauzolës 5.1 dhe në veçanti- por pa u kufizuar në këtë- do të përfshijë edhe ndonjë shpenzim shtesë të shkaktuar nga klienti për prokurimin e mallrave ose shërbimeve zëvendësuese nga ndonjë furnitor tjetër.

**5.3** Në rast se mallrat ose shërbimet janë të ndashme ose të liferuara në disa pjesë, klienti në diskrecionin e tij të vetëm mund të vendosë të zbatojë të drejtën e tij të vetëm për sa i përket mallrave që nuk janë liferuar ende ose shërbimeve që nuk janë realizuar ende.

**5.4** Furnitori nuk do të ketë të drejtë për ndonjë pretendim zhdëmtimi në rast se klienti e shkëput kontratën.

#### **Defektet e mallrave të liferuara**

**5.5** Furnitori garanton që mallrat përmbajnë cilësinë / specifikimet e rëna dakord dhe do të jenë

- të paktën për një periudhë 3 vjeçare pas pranimit të mallrave nga klienti

- të përshtatshme për përdorimin e rënë dakord ose për qëllimin zakonisht të pritshëm gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit.

Periudha e garancisë do të zgjatet për një periudhë të tillë kohore, gjatë së cilës mallrat defektive nuk mund të përdoren nga klienti në përputhje me kontratën për shkak të ndonjë defekti.

**5.6** Klienti do të inspektojë mallrat brenda një kohe të arsyeshme pas liferimit dhe do ta njoftojë furnitorin për çdo defekt të hasur gjatë inspektimit të tillë. Mosinspektimi i mallrave ose mosnjoftimi i furnitorit nuk do të ndalojë klientin nga të drejtat e tij të garancisë.

**5.7** Në rast se mallrat e liferuara nuk përmbajnë cilësinë/specifikimet e rëna dakord ose nuk janë të përshtatshme për përdorimin e rënë dakord ose qëllimin zakonisht të pritshëm në rrjedhën e zakonshme të biznesit, klienti nuk do të jetë i detyruar të paguaj çmimin blerës dhe e ka të drejtën të kërkojë në diskrecionin e tij të vetëm qoftë (i) riparimin e defektit brenda një kohe të arsyeshme, ose (ii) liferimin e mallrave zëvendësuese në përputhje me kontratën, ose (iii) një ulje të arsyeshme prej së paku 20% të çmimit blerës. Të gjitha shpenzimet në lidhje me mjetet kompensuese të përcaktuara në klauzolën 5.7 do të barten nga furnitori.

**5.8** Klienti ka të drejtë ta shkëpusë kontratën në rast se furnitori nuk e sanon defektin brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Me kërkesë të klientit, furnitori do të pajtohet t'i marrë prapa- pa asnjë shpenzim shtesë për klientin- mallrat dhe t'i pranojë ato në një vend të specifikuar nga klienti. E drejta e klientit për të kërkuar kompensimin shtesë nuk do të preket nga ndëshkimi kontraktual siç përcaktohet në klauzolën 5.7 dhe në veçanti - por duke mos u kufizuar vetëm në këtë - do të përfshijë çdo shpenzim tjetër të shkaktuar nga klienti për prokurimin e mallrave zëvendësuese nga një furnitor tjetër. Furnitori nuk do të ketë të drejtë të pretendojë ndonjë zhdëmtim.

**Defektet e shërbimeve të realizuara**

**5.9** Furnitori garanton që shërbimet do të realizohen në mënyrën e rënë dakord në kontratë ose të pritshme zakonisht në rrjedhën e zakonshme të biznesit.

**5.10** Në rast se shërbimet janë realizuar por jo si në mënyrën e rënë dakord në kontratë ose të pritshme zakonisht në rrjedhën e zakonshme të biznesit, klienti nuk do të jetë i detyruar të paguajë çmimin blerës dhe do të ketë të drejtë të kërkojë në diskrecionin e tij të vetëm, qoftë ( i) kryerjen e shërbimeve në mënyrën e rënë dakord në kontratë ose të pritshme zakonisht në rrjedhën e zakonshme të biznesit, ose (ii) një ulje të arsyeshme të çmimit blerës, ose (iii) – pas dhënies së një periudhe shtesë "grace" për kryerjen e shërbimeve në mënyrën e rënë dakord në kontratë ose të pritshme zakonisht në rrjedhën e zakonshme të biznesit – shkëputjen e kontratës. Të gjitha shpenzimet në lidhje me mjetet kompensuese të përcaktuara në këtë klauzolë 5.10 do të barten nga furnitori.

**5.11** E drejta e klientit për të pretenduar zhdëmtim shtesë nuk do të preket gjatë ushtrimit të veprimeve të tilla siç janë dhënë në klauzolën 5.10 dhe në veçanti - por duke mos u kufizuar vetëm në këtë - do të përfshijë çdo shpenzim të shkaktuar nga klienti për prokurimin e shërbimeve zëvendësuese nga një furnitor tjetër. Furnitori nuk ka të drejtë të pretendojë ndonjë zhdëmtim.

**6. NDËRPRERJA**

**6.1** Klienti ka të drejtë të shkëpus kontratën

- Në pajtim me klauzolën 3.3 ose klauzolën 5.2 ose klauzolën 5.8 ose klauzolën 5.10; ose

- Nëse furnitori nuk është në gjendje ose nuk do të jetë në gjendje të paguajë borxhet e veta teksa ato bëhen për pagesë, ose pezullon ose kërcënon të pezullojë kryerjen e pagesave në lidhje me të gjitha borxhet e tij, ose ndërmerr ndonjë veprim korporativ, ose fillohen hapa të tjerë ose procedura ligjore, për likuidimin, përfundimin, shpërbërjen, ose për riorganizimin e tij; ose për të filluar procesin e falimentimit ose likuidimit të tij, qoftë në mënyrë vullnetare ose të detyrueshme, ose një pretendim i është paraqitur gjykatës përkatëse për ta shpallur atë qoftë josolvent (të falimentuar), ose menaxhimi i jashtëm ose menaxhimi i falimentimit është miratuar në lidhje me të, ose është shpallur i falimentuar ose shkon në likuidim; ose

- Nëse për arsye të tjera, nuk mund të pritët që furnitori të përmbushë detyrimet e tij në lidhje me kontratën; ose

- Nëse respektimi i kontratës do të shkaktonte vështirësi të tepërta për klientin për shkak të një arsyeje të rëndësishme të shfaqur pas lidhjes së kontratës.

**6.2** Pretendimet e mundshme të klientit për zhdëmtim nuk do të preken nga një shkëputje e tillë.

**7. LIGJI RREGULLUES DHE JURISDIKSIONI**

**7.1** Kontrata dhe çdo detyrim jokontraktues që dalin nga ose në lidhje me të do të rregullohet nga ligjet e Kosovës pa iu referuar rregullave të saj të konfliktit të ligjeve.

**7.2** Çdo mosmarrëveshje që del nga ose në lidhje me kontratën do të zgjidhet përfundimisht nga gjykatat kompetente të Kosovës.

## **8. KONFIDENCIALITETI**

**8.1** Marrëveshja për mosshpalosje e RBKO-së ose marrëveshja e konfidencialitetit e RBKO-së e lidhur ndërmjet furnitorit dhe klientit do të jetë pjesë e pandashme e kontratës dhe dispozitat përkatëse do të përfshihen në këto TKP mutatis mutandis. Raiffeisen Bank Kosova i përpunon të dhënat personale të personave fizikë në përputhje me Ligjin Nr. 06 / L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR)2016/679.

**8.2** Furnitori jep pëlqimin e tij të qartë për RBKO-në që të dhënat personale të ofruara ose çdo e dhënë që mund të jetë në dispozicion më vonë mund të përpunohen ose ruhen me qëllim të realizimit të kontratës në të cilën furnitori është palë ose me qëllim të ndërmarrjes së hapave me kërkesën e të dyja palëve para lidhjes së kontratës, vlerësimin e ofertës së tenderit dhe çfarëdo qëllimi tjetër legjitim brenda kufijve të ligjit të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave.

**8.3** Përveç kësaj, furnitori i garanton RBKO-së që e ka marrë tërë pëlqimin e nevojshëm të punonjësve të tij, anëtarëve të bordit menaxhues, të bordit mbikëqyrës, të pronarëve dhe të pronarëve përfitues për të shpalosur të dhënat e tyre personale ose çfarëdo të dhëne tjetër RBKO-së me qëllim të realizimit të kontratës në të cilën furnitori është palë ose me qëllim të ndërmarrjes së hapave me kërkesën e të dyja palëve para lidhjes së kontratës, vlerësimin të ofertës së tenderit dhe çfarëdo qëllimi tjetër legjitim brenda kufijve të ligjit të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave.

**8.4** Furnitori pajtohet dhe e autorizon bankën që të dhënat personale të ofruara dhe çfarëdo e dhënë tjetër që mund të jetë e disponueshme më vonë mund të përdoren dhe shkëmbehen ndërmjet anëtarëve të Raiffiesen Bank Kosovë dhe partnerëve të saj brenda dhe jashtë vendit, Bankës Qendrore të Kosovës dhe subjekteve dhe institucioneve të autorizuara me ligjin në fuqi për mbledhjen dhe pranimin e të dhënave të tilla.

## **9. TË NDRYSHME**

**9.1.** Kontrata mund të ekzekutohet nga furnitori dhe klienti në çfarëdo numri të kopjeve ligjore, secila prej të cilave përbën një origjinal;

**9.2.** Furnitori nuk do të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij në lidhje me kontratën pa pëlqimin paraprak me shkrim të klientit.

**9.3** Në rast se furnitori është konzorcium ose një ndërmarrje tjetër e përbashkët kontraktuale, partneri kryesor do të jetë përgjegjës ndaj klientit për të gjitha dhe çdo përgjegjësi në lidhje me zbatimin dhe ekzekutimin e kontratës, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në përmbushjen e përgjegjësive dhe detyrimeve të parashikuara në kontratë, pagesën e taksave dhe detyrimeve, pagesën e kompensimit dhe dëmshpërblimit ndaj klientit etj., pavarësisht nga ndonjë dispozitë e kundërt e marrëveshjes së konzorciumit ose ndonjë marrëveshje ose aranzhim tjetër ndërmjet partnerëve. Çfarëdo komunikimi zyrtar në lidhje me ekzekutimin e kontratës do të bëhet nga klienti për dhe përmes partnerit kryesor.

**9.4.** Nëse çfarëdo dispozite e kontratës është ose do të bëhet pjesërisht ose plotësisht e pavlefshme, kushtet e mbetura do të vazhdojnë të zbatohen. Dispozita e pavlefshme ose pjesa e pavlefshme e dispozitës do të konsiderohet e zëvendësuar nga një dispozitë ligjërish e vlefshme, e cila i afrohet sa më shumë të jetë e mundur kuptimit dhe qëllimit komercial të dispozitës së pavlefshme ose pjesës së pavlefshme të dispozitës. Ky parim do të zbatohet gjithashtu mutatis mutandis në rast të ndonjë boshllëku kontraktual.

**9.5.** Furnitori e ka parasysh Kodin e Sjelljes të Raiffeisen Bank International per Furnitoret ("KS") dhe pajtohet që klienti kur hyn në kontratë ose kryen veprime sipas saj, do të ketë të drejtën t'i japë përparësi

KS-së. Megjithatë, furnitori nuk do të ketë të drejtë të mbështetet në KS-në, as të nxjerrë ndonjë të drejtë nga e njëjta. KS mund të përmes këtij linku

[https://www.rbinternational.com/content/dam/rbi/ho/home/sustainability-esg/responsible-banking/code-of-conduct/GroupSupplier\\_CoC\\_2024\\_Albanian.pdf.coredownload.pdf](https://www.rbinternational.com/content/dam/rbi/ho/home/sustainability-esg/responsible-banking/code-of-conduct/GroupSupplier_CoC_2024_Albanian.pdf.coredownload.pdf)

**9.6.** Përveç nëse është rënë dakord shprehimisht me shkrim nga klienti, cilado prej termeve dhe kushteve të përgjithshme të furnitorit nuk do të zbatohet. Në rast se klienti ka rënë dakord me shkrim që termat dhe kushtet e përgjithshme të furnitorit do të jenë të zbatueshme, dispozitat e këtyre KTP-ve dhe kontratës do të mbizotërojnë.

**9.7.** Furnitori duhet të respektojë të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret në fuqi dhe do të dëmshpërblejë klientin për çdo shkelje të tillë.

**9.8.** Klienti nuk do të jetë përgjegjës ndaj furnitorit për ndonjë dëm, përveç nëse dëmet e tilla janë shkaktuar nga pakujdesia e rëndë ose sjellja e qëllimshme e Klientit dhe pretendimet e tilla për zhdëmtim do të kufizohen në humbjet e drejtpërdrejta financiare të furnitorit. Në asnjë mënyrë klienti nuk do të jetë përgjegjës për dëmet indirekte ose rrjedhojëse, humbjen e prodhimit, humbjen e fitimit, etj.

**9.9.** Furnitori do ta dëmshpërblejë Bankën, drejtorët e saj, zyrtarët, punonjësit, shërbyesit dhe agjentët, për të gjitha humbjet, pretendimet, kërkesat, dëmet, veprimet, shkaqet e veprimit, kostot dhe shpenzimet (përfshirë shpenzimet ligjore) të cilat Banka mund t'i pësojë apo shkaktojë, që shfaqen drejtpërdrejt ose tërthorazi për shkak të: (a) ndonjë shkeljeje të kësaj Marrëveshjeje nga Furnitori, ose ndonjë agjent, punonjës, drejtor, zyrtar ose nënmarrëveshjeje e Furnizuesit; (b) veprimeve ose mosveprimeve të Furnitorit, ose të ndonjë agjenti, punonjësi, drejtori, zyrtari ose nënmarrëveshjeje të Furnitorit, përfshirë lëndimin ose vdekjen e ndonjë personi ose dëmtimin e ndonjë personi ose pronës, qoftë në mënyrë të qëllimshme, aksidentale ose nga pakujdesia. Ky dëmshpërblim do të vazhdojë të zbatohet edhe pas ndërprerjes së Marrëveshjes.

## **OFRIMI I SHËRBIMEVE**

**10.1** Furnitori do t'i ofrojë Shërbimet e porositura nga Klienti në përputhje me këtë Marrëveshjen, por jo më vonë se data e dërgimit të specifikuar në Marrëveshje. Furnitori Ofruesi duhet ta njoftojë Klientin dhe të marrë miratimin paraprak me shkrim në lidhje me çdo shtyerje të afatit të kryerjes së shërbimeve.

**10.2** Sa i përket vonesave në kushtet e dakorduara të kryerjes së Shërbimeve, Klienti rezervon të drejtën për të ngarkuar tarifën e dënimit në shumë prej 3% të faturës mujore, për secilën ditë të vonesës deri në datën e kryerjes së Shërbimeve.

**10.3** Në rast se vonesa tejkalon 3 (tri) ditë kalendarike, Klienti ka të drejtë ta ndërpresë këtë marrëveshjeje me efekt të menjëhershëm. Furnitori është i detyruar të paguajë 30% (tridhjetë) të shumës së dakorduar të marrëveshjes. Në një rast të tillë, Furnitori nuk ka të drejtë të kërkojë kompensime për dëme.

**10.4** E drejta e Klientit për të kërkuar kompensime shtesë për dëme mbetet e paprekur nga gjoha kontraktuale dhe në veçanti përfshin, por pa u kufizuar në, të gjitha kostot e shkaktuara nga Furnitori për blerjen e Shërbimeve zëvendësuese nga një tjetër Furnitor.